



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:196907

Datë: 21.11.2019

Numri i dokumentit: 00760656

**C.nr.1015/19**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Habib Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Sh.R, kundër të paditurit R.B nga fshati ..... komuna e Ferizajt, në çështjen juridike Rimbursim Dëmi, në seancën e mbajtur me datë 21 nëntor 2019, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, të njëjtën ditë mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. Aprovohet** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve “.....”, me seli në Prishtinë si e bazuar.

**II. Obligohet** i padituri R.B nga fshati ....., komuna e Ferizajt, që në emër të Rimbursimit të Dëmit si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 04 shtator 2016, ta kompensoj paditësin në lartësi prej 610 € (gjashtëqind e dhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë më 09 shtator 2019 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 20 € (njëzetë euro) të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit me shkrim të aktgjykimit, në të kundërtën mund të iniciohet procedura përmbartimore.

**A r s y e t i m i**

Më datë 09 shtator 2019, paditësi K.S..... ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit R.B, për shkak të Rimbursimit të Dëmit material si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 04 shtator 2016.

Lidhur me këtë gjykata ka caktuar seancën përgaditore më 21 nëntor 2019, e që po të njëjtën ditë me aktvendim procedural seanca përgaditore është konvokuar në seancë kryesore, duke i bazuar në dispozitën e nenit 420 par.3 të LPK-së, meqë palët nuk kanë paraqitur ndonjë propozim tjetër, e që si rrjedhojë do të nevojitej kohë për shqyrtim të propozimeve.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në gjatë seancës përgaditore dhe kryesor ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ashtu që pas administrimit të aprovet e njëjta, duke e kundërshtuar pretendimin e të paditurit për ekzistimin e institutit të parashkrimit, duke konsideruar se e paditësi më 09 nëntor 2016 e ka kompensuar të dëmtuarin, e cila konsiderohet datë e rrjedhës së afatit të parashkrimit.

I padituri përmes përgjigjes në padi por edhe gjatë seancës përgaditore, respektivisht asaj kryesore të datës 21 nëntor 2019 e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit vetëm sa i përket faktit se kërkesa e paditësit është parashkruar, duke theksuar se sipas përshkrimit të padisë aksidenti ka ndodhur më 04 shtator 2016, ndërsa padia është dorëzuar në gjykatë më 09 shtator 2019, e që sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve neni 357 thuhet *Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.*

Gjykata lidhur me këtë çështje gjatë seancës kryesore ka bërë administrimin e provave, dhe atë janë lexuar:

- Raporti i aksidentit ..... i datës 04 shtator 2016;
- Kërkesa për kompensim të dëmit e datës 09 shtator 2016 e bërë nga i dëmtuari R.S
- Marrëveshja jashtë gjyqësore e datës 28 tetor 2016 e lidhur mes të dëmtuarit R.S dhe palës paditëse
- Dëshmi pagesa me nr. 00000963 e datës 09 nëntor 2016 e lëshuar nga .....
- Kërkesa për rimbursim dëmi e bërë nga paditësja drejtuar të paditurit e datës 05 mars 2018
- Kërkesa për rimbursim dëmi e bërë nga paditësja drejtuar të paditurit e datës 09 tetor 2018
- Procesverbali mbi dëmtim në automjet i datës 09 shtator 2019 i përpiluar nga paditësja KS .....

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka konstatuar se kërkesë padia e paditëses në raport me dy të paditurit **është e bazuar**, për arsyt si në vijim:

Më datë 04 shtator 2016 në Ferizaj rr. “.....” kishte ndodhur aksident komunikacion, e që në atë aksident kanë qenë të përfshirë i padituri në njërën anë personi i quajtur R.S në anën tjetër,

e që sipas raportit policor i administruar si provë, është konstatuar përgjegjësia e tani të paditurit, ku mes tjerash është theksuar në raport se i padituri ka përdorur alkool gjatë vozitjes.

Bazuar në këtë, për gjykatën ky raport ishte bindës dhe qartësisht i sqaruar sa i përket përgjegjësisë të shkaktimit të dëmit. Për më tepër i padituri as në përgjigje në padi, por edhe gjatë seancës gjyqësore nuk ka prezantuar ndonjë provë apo ndonjë propozim me të cilën do ta vente në pikëpyetje raportin, sikundër që i padituri edhe provat tjera nuk i ka kundërshtuar drejtpërdrejt, dhe se kundërshtimi i tij i vetëm ka qenë aspekti i vjetërsimit-parashkrimit të kërkesës së paditësit.

Edhe provat tjera të administruar në gjykatë, siç janë; procesverbali mbi dëmtimin e automjetit, në të cilin janë përshkruar pjesët e veturës të dëmtuar, marrëveshja jashtëgjyqësore e datës 28 tetor 2016, si dhe provat tjera tregojnë për një përshkrim logjik dhe kronologjik të rastit, që do të thotë ekziston lidhja kauzale në mes raportit të policisë në të cilin është konstatuar aksidenti me provat tjera të administruara në gjykatë.

Bazuar në këto argumente, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe në të njëjtën kohë duke e obliguar të paditurën që ta kompensoj në emër të rimbursimit të dëmit, paditësen në lartësi prej 610 €. Kërkesëpadia e paditësit bazohet në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia Ligji nr. 04/L-018 neni 14 par.3 i këtij ligji i cili përcakton *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresive ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*.

Sa i përket pretendimit të paditurit lidhur me ekzistimin e parashkrimit, e që ka qenë pretendim i vetëm (pretendim i natyrës materiale-juridike) gjykata vlerëson se është i pa bazuar për arsyet si në vijim:

Çështja e parashkrimit është rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077) gjegjësisht në kreun 4, në nenin 357 të këtij ligji. Paragrafi 1 i këtij nenit përcakton *Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.*

Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se paditësja është njoftuar për dëmin më datë 09.09.2016 dhe atë bazuar në kërkesën e palës së dëmtuar nga aksidenti drejtuar paditëses, ndërsa paditësja padinë në këtë gjykatë e ka paraqitur më 09.09.2019, respektivisht paditësja më datë

05.09.2019 përmes postës i është drejtuar gjykatës lidhur me këtë çështje. Andaj bazuar në këtë, gjykata vlerëson se padia e ushtruar nga ana e paditëses është e afatshme dhe si rrjedhojë nuk konsiderohet se kërkesa e saj është e parashkruar, ashtu siç ka pretenduar i padituri përmes përgjigjes në padi dhe gjatë seancës kryesore.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së, andaj është obliguar e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për taksë gjyqësore në shumë prej 20 €.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**

**C.nr.1015/19, me datën 21 nëntor 2019**

**Gjyqtari,  
Habib Zeqiri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatën së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.